



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 110/1 Prot.

Tiranë, më 30. 01. 2020

V E N D I M

Nr. 15, Datë 30. 01. 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 4, datë 20.01.2020, e R. I., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR) dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër (në vijim DRSHTRR), me pretendim diskriminimin për shkak të “*gjendjes shoqërore*”¹ dhe “*çdo shkak tjetër*”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, në mes të tjerash, subjekti ankues deklaroi se diskriminohet nga ana e DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-së Shkodër, për shkak se ndaj tij Gjykata e Apelit Shkodër, me vendim Nr. 271, datë 26.04.2017, ka vendosur “*pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë me afat prej 4 (katër) vjet, me kusht që të mos kryej vepër tjetër penale*”. Ankuesi është rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me Nr. (NUIS) L47201004D, më datë 01.10.2014 dhe në Qendrën Kombëtare të Licencimit më datë 14.10.2014, për ushtrimin e aktivitetit të autoshkollës. Pavarësisht kërkesave të herëpashershme

¹ Si i dënuar nga ana e organeve gjyqësore

² Nuk është përcaktuar një shkak apo cilësi e veçantë nga ankuesi

drejtuar DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-së Shkodër, për rihapjen e këtij aktiviteti, nga ana e tyre i është revokuar Licenca e autoshköllës dhe i është mohuar rihapja e saj për shkak të dënimit të marrë nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Sipas ankuesit, ai i është drejtuar DRSHTRR-së Shkodër dhe DPSHTRR-së disa herë me kërkese për rihapjen e aktivitetit “Autoshköllë”, me anë të shkresave zyrtare dhe në përgjigje të tyre, është vënë në dijeni se shkak për revokimin e licencës është bërë dënimi i tij nga ana e gjykatës.

Në përfundim, ankuesi pretendon se arsyet e diskriminimit dhe refuzimit të rihapjes së aktivitetit “Autoshköllë” nga ana e DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-së Shkodër, lidhen me shkakun e gjendjes shoqërore, si i dënuar nga ana e organeve gjyqësore.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndalimin e diskriminimit dhe lejimin e ushtrimit të aktivitetit të tij privat.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi, ai i është drejtuar DRSHTRR-së Shkodër dhe DPSHTRR-së disa herë me kërkesa për rihapjen e aktivitetit “Autoshkollë”, me anë të shkresave: datë 22.02.2018 (protokolluar pranë DRSHTRR-së me nr. 1049 prot., datë 13.03.2018); shkresë pa datë (protokolluar pranë DPSHTRR-së me nr. 6567, datë 20.04.2018) dhe shkresa datë 01.10.2018, datë 02.11.2018 (protokolluar pranë DRSHTRR-së me nr. 5473, datë 07.12.2018). Në përgjigje të tyre, DPSHTRR dhe DRSHTRR Shkodër i kanë kthyer përgjigje ankuesit me anë të shkresave: **nr. 1049/1 prot., datë 16.03.2018; nr. 6567/2 prot., datë 03.05.2018;** nr. 2303/1 prot., datë 28.06.2019; nr. 15870/2 prot., datë 02.08.2019; nr. 3120 prot., datë 26.09.2019 dhe nr. 20519/2 prot., datë 16.10.2019.

Bazuar në ankesën Nr. 4, datë 20.01.2020, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, R. I. është njohur me sjelljet diskriminuese nga ana e DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-së Shkodër, me anë të shkresave **nr. 1049/1 prot., datë 16.03.2018; nr. 6567/2 prot., datë 03.05.2018.** Pra, referuar shkresave dhe provave të vëna në dispozicion nga ana e ankuesit, evidentohet se situata diskriminuese e pretenduar prej tij, ka ndodhur dhe ai ka marrë dijëni për të, më **datë 16.03.2018**, kohë në të cilën nga ana e DRSHTRR-së Shkodër, ankuesi është njohur me refuzimin për pajisjen me licencë për shkak se është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Mashttrimit”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “**Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt**”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e ankesës nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “*Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente*

sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëshmëpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”, 2: “Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje”,* ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE:

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/dh të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së R. I., për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shoqërore dhe çdo shkak tjetër)
(Fusha: Shërbime)